


MIRATOI

KRYETARI I BASHKISE

ERISELDA SEFA



## RELACION TEKNIK

Objekti: REHABILITIM I GODINES SE PALESTRES NE KRUTJE

Njesia Administrative KRUTJE , Bashkia Lushnje



## RELACION ARKITEKTONIK

Objekti: REHABILITIM I GODINES SE PALESTRES NE KRUTJE

**Në projektin e parashikuar, synohet rijetësimi i palestrës duke e rikonstruktuar me qëllim zhvillimin e aktiviteteve kombetare duke i dhëne vlerën që ka pasur.**


### Gjendja Ekzistuese

Palestra shtrihet përballë njësisë administrative dhe postës. Objekti aksesohet në veri, ka formë të rregullt drejtkëndore me mbulesë tarrace dhe lartësi maksimale 9.20 m. Në katin përdhe  $\pm 0.00$  bën pjesë fusha e volajbollit, 2 rreshta ndenjësë për spektartoret dhe ambjentet ndihmëse në funksion të lojtarëve. Objekti ka një gjysëm kati (+ 2.72) i cili është i aksesueshem nga i vetmi korpus shkallësh pranë hyrjes dhe është në funksion të spektatorëve me anë të 4-5 rreshtave shkallarë. Sipas planimetrisë së fundit të zbatuar, vëmë re se sistemi konstruktiv është i ndërtuar me mure perimetralë mbajtës 40 cm dhe mure ndarëse 25 dhe 12 cm. Nga vrojtimet në objekt, konstatojmë se ai ka 2 akse me kolona betoni 43 x 83 cm në drejtim gjatësor. Në ambjentet e brendshme, sistemi konstruktiv i objektit shfaqet pjesërisht i dëmtuar në tavanet e kthinave të garderobave dhe nyjeve higjieno sanitare. Zgavrat e hapura në formë dritarësh, ku ndahet ambjenti i fushes nga zyrat janë vetëm me hekura. Degradime të mëdha ka pësuar shtresa e suvasë duke krijuar lagështire nga demtimi i hidroizolimit, faktorët atmosferikë dhe mungesa e mirëmbajtjes së objektit gjatë viteve. Objekti merr ndriçim dhe ajrim natyral me anë të dritareve në dy faqet anësore të tij dhe hapësirave të brendshme ku behët ndarja e fushes së volejbollit me dhomat e shërbimit. Nga ana konstruktive objekti ai nuk ka pëuar dëmtime dhe çetime të ndryshme. Për kete arsye mendojme të mos realizohen nderhyrje thelbesore në konstruksionin e objektit. Parashikohet të shtohet një strehe e cila do të jetë me polikarbonat me veshje druri të lëmuar midis strukturës së saj.

**Nga konstatimet në vend, gjendja e fasadave paraqitet me dëmtimet e shënuara më poshte:**

**Patine biologjik** - kanë krijuar një shtresë myku dhe liknesh mbi sip. e murit apo suvasë. Janë formuar si rezultat prezencës së lagështirës për shkak të dëmtimit të pikoreve për kullimin e ujërave dhe mostharjes së sip. së suvasë ku llaçi i përdorur nuk ka pasur përbërje lagështire thithëse.

**Prezenca e lagështisë** - krijohet si shkak i infiltrimit të lagështirës në shtresën e suvasë dhe mos shkeputje e ujërave të shiut në sip. e duhura horizontale, por rrjedhjes në sip. e murit.



**Shkeputje e suvasë-** si rezultat i mbajtjes së ujit në brendësi të materialit, ngrirja shkrija krijon kripërat dhe dëmtimin tullave e llaçit lidhës së suvasë deri në shkëputje.

**Davancale/ parapete te demtuar** janë krijuar me beton të lehtësuar dhe në permbajtje kanë cimento llaçi i së cilës është me i devotshëm ndaj lagështires sesa ndaj gëlqeres.


**Telat e korentit** të shpërndara në mënyrë sporadike e pa kriter ne fasaden perëndimore të objektit janë bërë për të plotësuar nevojat e menjëhershme të përdoruesve. Mund të bëhen burim dëmtimi jete.

**Kalbja e drurit te dritareve** ka ardhur si shkak i mos trajtimi dhe lyerja e duhur e lendës drusore me vaj lini. Ajo është bymyer deri në degradim.


### Ndërhyrjet e parashikuara për rikonstrukcion:

**Fusha e vojelbollit dimensione 10 x 9 m do të lyhet me bojë hidrtomat ngjyrë të bardhë.**

Është parë e arsyeshme që me spatul dhe furcë teli të butë do të bëhet heqja e suvasë së degraduar te vjetër pasi ka humbur aftësinë e saj mbrojtëse. Pas zhveshjes së objektit nga suvaja ekzistuese, i duhet dhënë kohë muraturës të thahet (në zonat ku ka mbajtur lagështirë) përpara se të risuvatohet. Do të hiqen të gjitha dritaret e dyert ekzistuese prej druri, duke u zëvendësuar me mareriale d/alumini me të njëjtin dimension. Zgavrat e hapura ne forme dritaresh, ku ndahet ambjenti i fushes nga zyrat do te pajisen me dritare me nje kunete.





Dritare TIP 1 duralumini një kanatëshe, dopjo xham transparent, ngjyrë druri, në ambjentin e brendshëm të objektit, gjithësej 7 cope.






Dritare TIP 2 duralumini, 2 kanata të hapshme me rrëshqitje, dopio xham transparent, në fasadën veri jug të objektit. Gjithësej 4 cope.





PRERJAA - A




PRERJAA - B


Dritare TIP 3 duralumini, pjesa e sipërme sopraluce, pjesa poshtë e hapshme në 2 kanata, dopio xham transparent. Gjithësej 4 cope.



Dritare TIP 4 duralumini, 2 kanatëshe të hapura me rrëshqitje. Gjithësej 4 cope.



Dritare TIP 5 (120 x 130) duralumini, 1 kanatëshe të hapura me rrëshqitje. Gjithësej 8 cope.  
Dritare TIP 6 duralumini 1 kanatëshe, me rrëshqitje 1 cop.



Nuk do të parashikohet zgjerim apo ngushtim i muratures, përveç derës së aksesit në kuotën + 2.72, e cila do të zgjerohet 28 cm. Në pjesën e brendshme të gjitha dyert e ambjenteve ndihmëse aktualisht kanë lartësi 1.95 m, ne propozojmë të behet 2 m. Do të realizohet pastrimi i materialit të drurit të dalë në tavanin e kthinave të nyjeve H/S. Zona e shërbimeve është e aksesueshme nga dera ekzistuese (150 x 220 cm) në fund të korridorit. Projekti propozon hapjen e një tjetër dore (90 x 220) në një nga dritaret e brendshme. Garderobat dhe nyjet H/S f/m do të kenë të njëjtin funksion edhe në projektin e parashikuar. Parashikohet ndarja e tyre me derë (128 x 220 cm) me xham të temperuar. Ato do të rikonstruktohen totalisht, me suvatime të reja, shtrime pllakash me porozitet për mos lejuar rrëshqitjet dhe vendosje të një nyje H/S alla turka (sipas kushteve të projektimit në fuqi, për objekte të këtij lloji), 1 lavaman dhe 3 dushe të ndara me mure 12 cm me lartësi deri në + 1.90 m. Në selilin dush parashikohet piletë horizontale dhe dyshemeja do të këtë pjerresi 1%. Dhomat propozohen me këto funksione: dhomë mjeku për ndihmën e shpejtë, dhomë albitrash, zyrë, depo për material dhe dhoma elektrike e cila ka qënë ekzistuese. Nyjet H/S, depoja dhe dhoma elektrike propozohen me të njëjtin tipologji shtrimi pllake ngjyre bezhe, ndërsa dhomat e tjera parashikohen me parket laminat 7 mm. Kati në + 2.27 ka trajtën e një ballkonate e cila i dedikohet tërësisht spektatorëve. Do të krijohen 3 shkallarë me lartësi h = 50 cm dhe 4 rreshta më ndenjese (50 x 40 cm). Kati do të shtrohet me pllaka gri (30 x 30 cm) dhe do të marrë ndrucim dhe ajrim natyral nepermjet dritareve (300 x 145 cm).

Ne fasada do të realizohet pastrimi nga ndryshku dhe trajtimi me anti ndryshk i elementeve metalike të parmakut të shkalleve. Ne fund do të lyhen me ngjyre bakri. Do të sistemohen kabllot elektrike të kapur në fasadë në mënyrë të papërshtatëshme. Fasada do të trajtohet me suva plastike grafiato ngjyre të bardhe, shkallet propozohen me mermer, hyrjet do të aksesohen nga dyer me teksture druri dhe do të krijohet një strehe druri me gjeresi 120 cm e cila do të pesoje këthese duke vijuar me të ngjyten gjeresi, përgjate fasades verilindore. Duke qënë se nuk ekziston një strehe, është menduar të shtohet një e tille si një element funksional dhe modern për kohën. Ne dritaret TIP 5 të kësaj fasade parashikojmë korniza në formë "L" të krijuara me llaç gëlqere dhe çimento. Në rastin e dekoreve, përdorimi i çimentos është i përshtatshëm duke qënë se elementët e dekorit janë më të ekspozuar se suvaja në përgjithësi si ndaj dëmtimeve që vijnë për shkak natyrorë (agjentët atmosferikë) si ndaj dëmtimeve mekanike. Gjithashtu kemi parashikuar panele druri brisolei për hijezim. Sistemimit të jashtëm i është dhënë një rëndësi e veçantë. Rruga do të shtrohet dhe do të ketë trotuare me gheresi 120 cm. Projekti propozon një lulishte e cila ka akses drejteperdrejte me rrugën hyrëse në korpus. Pranë saj parashikohen 8 vende parkimi për makina si dhe parkim bicikletash. Brenda lulishtes zhvillohen elemente forme organike ku parashikohen të vendosen stola druri. Shtrimi do të behet me pllaka 40 x 40 cm, ngjyre gri e celet dhe pjesërisht dru. Trotuari do të ketë pjerresi 8 % me qëllim aksesin e personave me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Ndricimi propozohet të realizohet i lartë 9 m dhe i ulet forme kerpudhe me lartësi 40 cm. Gjithashtu, projekti parashikon kontenieret e mbetjeve. Sistemimi i gjelberimit është totalisht në funksion të banorëve të zonës dhe lojtareve.

Gjate viteve nuk jane bere ndryshime te njepasnjeshme nga persona per interesa vetjave. Projekti synon qe objekti te ruaje formen arkitektonike te kohes ne te cilen eshte ndertuar, ne kombinim me elemente te lehte moderne te cilet do te qendrojne ne harmoni me pamjen e tij ne kompleks

## RELACION TEKNIK ELEKTRIK

Objekti ne fjale eshte palester sportive. Projekti bashkengjitur eshte konceptuar ne baze te kerkeses se investitorit per realizimin e instalimeve elektrike dhe furnizimit me energji te objektit ne fjale. Furnizimi me energji i objektit do te behet ng rrjeti publik TU 0.4kV.

Ky objekt kategorizohet ne objekte sociale, gje e cila do te trajtohet e tille dhe ne kete projekt ne baze te kushteve teknike te ketyre kategorish objektesh.

### 1. FURNIZIMI ME ENERGI

Furnizimi me energji sic u tha dhe me siper do te behet nga rrjeti publik 0.4kV.

Paneli KE-1 do te lidhet ne skemen e kabines elektrike ekzistuese te rrjeti publik. Per hollesira shihni vizatimin e panelit KE-1.

Nga kabina ekzistuese e transformacionit do te dali nje fider qe do te ushqej panelin elektrik. Paneli elektrike do te instalohen ne katin (0) ne ambientin teknik.

**Eshte bere llogaritja per percaktimin e fuqise se kerkuar.**

### 2. ZGJEDHJA E SEKSIONEVE TE KABLLOVE

Kushtet e perzjedhjes te seksionit te kabllove:

- Rrymes se lejuar
- Renievetetensionit
- Ngrohjestermike

a. Zgjedhja e seksionittekabllove per urrat e te TR (TM/TU)

Duke u nisur nga fuqia e transformatorit, automati kryesor ne TU, anen sekondare te transformatorit, nga te dhenat e katalogve na rezulton:

b. Llogaritje e ngarkesave te paneleve kryesor & zgjedhja e seksionit te kabllove per linjat e paneleve.

c. Kuadri kryesor do te furnizohet nga rrjeti publik me kabell 4x70mm<sup>2</sup>.

Te gjitha paisjet komutuese te kabines elektrike ne pjesen e TU do te jen me fuqi ckycese 10kA.



### 3. RRJETI ELEKTRIK

Linjat elektrike qe furnizojne konsumatorët elektrik do te furnizohen nga kablllo bakri qe te cilet shtrihen ne nje kanaline metalike, qe montohet vertikalisht/horizontalisht ne nje faqe muri. Kjo kanaline eshte e ndare ne dy pjese per te bere te mundur montimin rrjeteve te rrymave te dobeta.

Keto linja jane me percjellsa te standartit NO7V-K, te futurne tubo fleksibel PVC te forte  $\Phi 20-25\text{mm}$  nen pllaka te dyshemese dhe mbi tavanin e varur.

- Linjat e prizave dhe ndricimit ne apartamentet e banimit mbrohen me automate termomagnetik nje polar te montuar ne kuadrin elektrik te apartmentit.

- Per Boilerin	- linje S = $3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ , In=16A
- Per Priza PC	- linje S = $3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ , In=16A
- Per Prizasherbimi	- linje S = $3 \times 2.5 \text{ mm}^2$ , In=16A
- Per fancoil	- linje S = $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$ , In=10A
- Ndricuesa	- linje S = $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$ , In=10A
- Ndricuesa emergjence	- linje S = $2 \times 1.5 \text{ mm}^2$ , In=10A

- Linja e ndricimit nga kuadri elektrik ne celesat e ndricimit realizohen me percjellsa te tipit NO7V-K ne seksion  $3 \times (1 \times 1.5) \text{ mm}^2$  te futur ne tubo PVC te forte fleksibel  $\Phi 20-25\text{mm}$  nen pllaken e dyshemese dhe mbi tavani e varur.

Linja e ndricimit nga celesi i komandimit ne ndricues do te realizohen me kabell seksion  $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$  i futur ne tub fleksibel te rende  $\Phi 20-25\text{mm}$  ne pjesen vertikale te murit. Ndricimi i korridorit do telekomandohet nga nje sensor levizje IR.

- Burimi i pare dhe i vetem i energjise eshte rrjeti publik, ku jane te furnizuara te gjitha pajisjet e kondicionimit, ndricim i jashtem dhe element ndihmes te objektit.
- Ky burim do te kete pike shperndarje per katet panelin elektrik KE-1, i cili do te furnizoj me energji gjithe konsumatorët elektrik te instaluar ne objekt. Per hollesira te metejshme referojuni vizatimeve.
- Lartesite e vendosjes se paisjeve mbi dysheme e mbaruar
  1. Celsat e ndricimit 0.9-1.5m
  2. Prizat 0.2.-0.4m,
  3. Daljedritemurale 1.75m
  4. Kuadri elektrik i 1.6m (aksi i mesit i kuadrit)
  5. Prizat e telefonise 0.4m

Per detaje te metejshme shihni vizatimin tip te insalimeve elektrike te pergjithshme.



#### 4. TOKEZIMI MBROJTES DHE I PUNES

Duke qene se sistemi i furnizimit me energji elektrike eshte nga kabina e elektrike, tokezimi i mbrojtjes do te jete i njejte me tokezimin e punes. Pra buloni i nulit te trafos do te lidhet me percjellesin e tokes. Ndersa per gjithë shperndarjen pas panelit elektrik KE-1 do te jete TN-S.

Keshtu:

- Per objektin eshte parashikuar tokezim i mbrojtjes prane kabines se transformacionit. Ky tokezim llogaritet ne vleften  $R_{tokes} \leq 2.7 \Omega$ , dhe lidhet me zbaren e nulit te transformatorit.
- Tokezimi i punes eshte realizuar nepermjet rrjetes se tokezimit ne cdo objekt, me ane te se cilit nga paneli tokezohe percjellesi i nulit te kabllave furnizuese te prizave. Nese nuk realizohet vlefte e  $R_{tokes} \leq 2.7 \Omega$ , me numurin e elektrodave te paraqitura ne projekt, atehere duhet te realizohet tokezim artificial, duke perpunuar vendin ku do te behet tokezimi. Ky sistem kategorizohet si TN-S, prandaj eshte ekstremisht e ndaluar qe mbas bashkimit te neutrit me rrjetin e tokezimit ne panelin elektrik kryesor te ribashkohen ne pje te tjera te qarqeve sekondare.

Ne projekt eshte parashikuar edhe mbrojtja nga shkarkimet atmosferike. Edhe per kete mbrojtje vlen sugjerimi se nese nuk realizohet vlere e tokezimit te rrufe priteses me e vogel se  $\leq 2.7 \Omega$ , duhet te realizohet tokezim artificial.

#### 5. NDRICIMI I JASHEM DHE PAJIS NDIHMESE TE GODINES

Ne kete pjese perfshihet ndricimi i jashtem i teritorit, dyer elektrike, pompa drenazhi etj.

Per kete arsye projekti mer parasysh ne KE-1 nje skeme te vecant i pajisur me te gjitha elementet elektrik te nevojshem per permbushjen e qellimit dhe gjithashtu me nje mates energjie qe do te shenoj gjithë konsumin e energjise per te gjithë godinen.

Ky panel do te furnizohet nga kabina elektrike ekzistuese dhe do te venoset ne ambientet teknike te objektit ne katin 0

Ndricimi i jashtem eshte i parashikuar te instalohet me prozhektor 70W te instaluar ne lartesine 6m nga toka ne perimenter te fasades. Komandimi i ketij ndricimi do te behet nga paneli elektrik KE-1 me ane te reles korpuskulare (foto element).

#### 6. SISTEMET E RRYMAVE TE DOBETA

Per sistemet e rrymave te dobeta projekti do te parashikojë vetem insatlimet e rrjetit pasiv te brendshme. Ndersa per lidhjen me ISP dhe kompanit telefonike do te perdoret infrastruktura inxhinierike qe do te parashikohet me pare dhe do te lihet e gatshme per cdo kerkes lidhje me jasht.

Rrjeti data dhe telefoni parashikon per cdo post pune nje prize RJ-45 CAT6 dhe nje prize telefonie RJ-11.

Per pajisje si printera dhe plotera ne rrjetin LAN eshte parashikuar nje prize RJ-45 CAT6.

Sistemi i brendshme data do te jete CAT6, ndersa ai telefonik CAT3.

## RELACION TEKNIK HIDROSANITAR - MBROJTJE NGA ZJARR

Godina e Palestrës në Komunën e Krutjes së qytetit Lushnjës është një objekt që është ndërtuar prej shumë vitesh dhe që ka kryer funksionin e saj më së miri si palestër për komunitetin e fshatit Krutje dhe sidomos për ekipin e volejbollit të femrave që e kanë patur si shtëpinë e tyre . Me kalimin e viteve si dhe gjatë periudhës së tranzicionit ky objekt ka pësuar ndryshime jo si strukturë konstruktive ,apo si funksion por me kushtet e stërvitjes që ai ofron . Kështu le të themi se kushtet e sotme të Palestrës ku stërvitet ekipi i të rejave dhe të rriturave të volejbollit lenë shumë për të dëshiruar , që ke kushtet e përgatitjes fizike , te ato të materialeve sportive e deri te kushtet higjienike . Me pak fjallë cdo element isaj është për tu rikonstruktuar . Në ambientet e shërbimit të palestrës , përvec dhomave të zhveshjs , terapisë apo atje ku mbahen materialet e stërvitjes, dyambiente të zënë ambiente sanitare , të cilat janë egzistuese por në gjëndje të mjerushme. Rikonstruksioni i tyre do të jetë i plotë duke filluar që ke rifiniurat , pllaka shtrimi dyshe me mure suvatime ,lyerje hidroizolime , dyer ,dritare dhe çështë më kryesorja rikonstruksioni i plotë i sistemit të furnizimit me ujë dhe shkarkimeve si dhe vendosja e re e aparateve sanitare. Ne instalimet H/S perfshihen (furnizimi me uje te ftohte dhe te ngrohte te paisjeve sanitare ,kanalizimi (ujrave te zeza dhe te bardha) dhe mbrojtja nga zjarri e objektit.

### SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE

**Struktura e shperndarjes së ujit në nyjet sanitare dotë perbëhet nga këto komponente:**

- Furnizimi me uje i nyjeve sanitare dhe aparateve sanitare të veçanta .
- Do të merret pika e furnizimit nga pompa e vendosur pranë pusit që është dhene ne sheshin ku ndodhet dhe objekti jone , prurja e kerkur per objektin tone eshte  $q= 0.4-0.50l/sec$  , tubacioni i furnizimit me uje eshte  $\varnothing 32$  mm PPR . Duke mos patur nje informacion mbi gjëndjen sot , ku uji që vjen nga pusi nëpërmjet pompës nuk është i pastër qoftë edhe për larje projektuesi parashikon që ose të përmbrohet pusi egzistues duke e thelluar deri sa të arrijë në shtresa të mira të përshtatëshme nga ana higjienike ,ose të hapet një pus i ri brenda kushteve teknike të zbatimit dhe i certifikuar nga Drejtoria e Higjenës për përdorim . Kjo është një zgjidhje , zgjidhja tjetër është lidhja me rrjetin egzistues të zonës nqs ka Për të siguruar ujë për gjithë kohën që kjo palestër frekuentohet projektuesi mendon vendosjen e dy depozitave me  $v= 2000$  litra , në secilën tarracë të nyjeve sanitare , nga ku mbushja do të kryhet me pompë dhe shpërndarja me rrjedhje të lirë deri tek secili aparat
- Për palestrën (objektin tonë) është vendosur një kontator (matës ujit) komplet me filter e kondravalvul e saracineska komandimi  $\varnothing 1''$  ose PPR dn 32 mm PN10 ne hyrje te tij .
- Sistemi i shperndarjes eshte zgjedhur sistemi klasik i shperndarjes me grup pompimi. Tubat qe perdoren per ujin e ftohte dhe te ngrohte jane te cilesise se pare PR-P cilesi e çertifikuar (UNEN ISO 9001-2000)po me te njeften cilesi do te jene edhe rakorderite e tyre.



- Shperndarja neper nyjet sanitare behet me sistemin klasik , në mure dhe shtresë dysHEMEJE të termoizoluara dhe dimensionuara , nga projektuesi në cdo aparat sanitar. Persa i perket ujit te ngrohte ne kete objekt ,ky eshte realizuar me bojlere elektrik ne te dyja ambjentet sanitare.

## **IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJE**

Per furnizimin ne menyre te panderprere te ujit per 24 ore si dhe per realizimin e presionit te deshiruar ne paisjet H/S eshte parashikuar impianti I furnizimit me uje.

**Ne perberje te ketij impianti bejne pjese:**


### **REZERVUARET E UJIT (te pergjithshme)**

Per objektin tone nuk eshte parashikuar ndonje rezerve uji e cila do furnizohej nga pompa egzistuese, ose e re . Rezervuarët e parshikuar janë rezervuarë horizontale zingato me  $V=2000$  litra secili , pra gjithsej  $4\text{ m}^3$  . Këta rezervuarë janë të tipit "CORDIVAR " të pajisura me galixhand dhe shkarkues sipas normave të UNI- t Rezervuari mund të jetë dhe i para përgatitur por në të gjitha rastet duhet të plotësojë kushtet e mëposhtëme:

1. Te respektojne normat UNI 9182
2. Te jete hermetike per te parandaluar ndotjen e mundshme.
3. Te jete realizuar prej materiali qe nuk ndot ambjentin dhe nuk eshte toksike, si dhe te jete i veshur mundesisht nga ndonje material te pakorodushem(zingato ose inoks) qe te jete sa me higjenik .
4. Te jete i paisur me paisjet e shkarkimit (tropopieno) boshatisje ne rast nevoje ,valvol te moskthimit ne dergim,valvola te nderprejtes ne hyrje dhe dalje si dhe valvol per nxjerrjen e ajrit.
5. Te jene te paisur me dizpozitivin e ndrimit te ujit nje here ne cdo dy dite, ne rastet kur nuk ka konsum.
6. Te lejoje mundesi per inspektim te jashtem dhe te brendeshem.
7. Nderprejta e furnizimit te realizohet nepermjet galixhantit mekanik.

### **Grupi i pompimit te ujit (te pergjithshme)**

Ky grup perbehet nga nje njesi pompimi qe lidhet me rezervuarin e ujit . Njesia ne vetvete perbehet nga nje ose dy pompa me prurje te llogaritura per te perballuar kerkesen e konsumatoreve. Funksionimi eshte i tipit automatik qe realizohet nepermjet presostateve diferenciale me dy nivele(nga nje per secilen pompe) qe siguron leshimin dhe ndalimin ne formen e nje kaskade sekuenciale.



Per te percaktuar performancat e pompes si prurjet, presionin, fuqite etj, llogariten perkatesisht sasite e nevojshme te ujit per nevoja te konsumatoreve. Ne rastin e objektit tone meqenese tubi i furnizimit lidhet direkt me st e pompave te paraqitur ne plan vendosje, qe vjen nga pusi . Karakteristikat teknike jane te pergjitheshme per cdo pompe pavaresisht nga karakteristikat hidraulike te ndryshme.

**Grupi i pompave eshte pompe vertikale ose horizontale teke me keto karakteristika:**

Prurja 2.8 m<sup>3</sup>/ore 3400 -2400litra/orë (prurja min/max)

Tarimi , presostati , prevalenca. H=25-15m

Grupi i pompave eshte paisur me kolektor zingato, thithje dhe shkarkimi, presostat te presionit te ulet dhe te larte, galexhante elektrik, kuader elektrik per leshimin dhe mbrojtjen. Ai ka ne perberje rregullatorin elektronik per funksionimin ne menyre te shkallezuar te pompave, si dhe mbrojtjen ne rastet e ndrimt (mungese faze ne qarkun elektrik).

- Grupi eshte i paisur me nje valvol sigurie 10 bar
- Per te evituar rezonancat ose tensionet mekanike duhet te instalohen suporte mbeshtetese
- Gjithashtu duhet te vendosen suporte mbeshtetese ne tubat e kolektoreve te dergimit dhe kthimit.
- Bazamenti duhet te jete prej betoni dhe mberthimi te kryhet me amortizatore.
- Çdo pompe eshte e kontrolluar nga nje kuader elektrik independent.

### **Autokllava**

Autokllave per çdo grup pompimi. Ajo eshte paisje e perzgjedhur dhe e dimensionuar per te mbajtur ujin ne serbator midis dy vlerave limit te presionit, per te kenaqur kerkesat e perdoruesit duke rritur ne menyre automatike presionin e ujit ne rrjetin shperndares , i cili nuk sherbehet mire per diferenca te presionit te rrjetit. Ajo eshte nje paisje ideale kunder grushteve hidraulike ne rrjetin e ujit.



Autokllava eshte nje paisje hermetikisht e mbyllur ne te cilin nje volum i caktuar ajri mbahet nen presion nga nje jastik ajri i komprimuar.

Autokllava kerkon nje hapsire te caktuar. Dimensionet e autokllaves jane nen perputhje me prurjet e pompave, si dhe me vlerat max dhe min te tarimit te presostateve si dhe nr te nisjeve/ore te pompave. Ne rastin tone nqs vrtet do duhej nje rezervuar uji , nje pompe ,kjo do te shoqerohej me nje serbator me membrane. Ky serbator do jete 24 litra .Karakteristikat qe duhet te kete jane Prurja max e grupitKapaciteti I autokllaves v= litra Standarti AFL-1000 Dj (mm , )

H (mm) , Lidhja F 1''

### **SISTEMI I SHKARKIMEVE KANALIZIMEVE DHE DRENAZHIT**

Sistemi ne fjale perfshin shkarkimet hidrosanitare ,ato te drenazhit etj.

Tubat qe do te perdoren per shkarkimet e ujrave te zeza e te bardha, si dhe rakorderite perkatese do te jene sipas DIN EN 1451. Materiali i tyre do te jete polipropilen i termostabilizuar ne temperatura te larta. Ngjyra e ketyre tubacioneve do te jete gri ose te zeza dhe do te jene te amballazuara ne te gjitha llojet e gjatesive, L max=750cm.

Konstruktivisht lidhjet e tubacioneve do te jene elastike ne saje te lidhjeve fundore te tyre ,te cilat realizohen ne formen e xhuntove me gote dhe guarnicione elastike ne brendesi te tyre.

Dimensionimi si dhe menyra e instalimit te tyre jane dhene ne projekt.

### **KUSHTET TEKNIKE TE MONTIMIT**

1. Fiksimi i tubave te shkarkimit behet me ane te kollonave ne siperfaqe te gomuar te cilat nga ana e tyre fiksohen me anen e takove plastike dhe vidave metalike.
2. Kollonat jane dy tipe: kollona fikse dhe kollona te rreshqiteshme.  
Te dyja sipas rastit perdoren per montimin e kollonave te shkarkimit.
3. Te gjitha tubat e shkarkimit do te jene te shoqeruara me sistemin e ajrimit i cili ne rastin tone nuk ka nevojë për tub shoqërimi por kryhet vërtëm ajrisja e kollonës lart ose dalja esaj anësore nën soletën e katit të parë , ku shpërfryn jashtë nëpërmjet një grille(kjo pasqyrohet edhe ne projekt).
- 4 Kollonat me dalje ne terrace duhet te kene nje lartesi jo me pak se 70cm.
- 5 Per te lejuar pastrimin e gjithe rrjetit te shkarkimit duhet te vendosen pika shkarkimi ne hapsira te tilla si nje kat po dhe nje kat jo.
- 6

Dimensionimi i tubacioneve behet ne baze te prurjeve nga perdorimi max i paisjeve. Persa i perket rrjetit te paisjeve ka disa diametra qe perdoren brenda nyjeve duke filluar nga Ø40~Ø100mm.

dhe nga Ø100mm ~ Ø200 mm ~ e keshtu me rradhe deri tek magjistralet e jashtme. qe përfundojnë te gropa septike sepse nuk ka rrjet egzistues të kanalizimeve të komunës pranë objektit.

Nyjet sanitare qe jane me ventilim natyral skane nevojte per ventilator .


Ne kete sistem futen edhe sistemi i ujrave te shiut qe jepet nga arkitekti. Rrjeti mbledhes i tyre mund te jete i vecante ose i perbashket me ujrat e zeza , kjo eshte nje zgjithje qe jepet edhe nga diskutimi me investitorin. Pusetat e kanalizimit apo keto te ujrave te shiut mund te ndertohen me mur tulle, ose beton M 200, ato te kanalizimit jane kryesisht Ø0.8-1m ,ndersa keto te ujrave te shiut jane 40x40mm dhe 40x60mm me kapak me zgare hekuri ose gize. Mbledhja e kanalizimeve do behet ne rrjetin qe mund të kete zona ose ne rast të kundërt do të realizohet me **Gropë Septike** e cila duhet të realizoje KTP dhe KTZ per projektimin dhe ndertimin e tyre qe janë në vendin tone në fuqi. Për ndërtimin e gropës septike do merret leje nga organet përkatëse që janë në fuqi në vendin tonë . Në rastin tonë egziston një gropë septike që është në gjëndje jo të mirë pune , prandaj gjatë zbatimit të punimeve duhet të verifikohet dhe të meren masa ose të rikonstruktohet ose të braktiset dhe të ndërtohet një e re me parametrat dhe kapacitetin e duhur



*[Handwritten signature]*

.Nga llogaritjet paraprake për palestën duhet një gropë septoke 6-10 m<sup>3</sup> ku vendi vendi më i përshtatshëm është në pjesën e sipërme të objektit pranë banjave me dimensione 3x2x1.5 , beton arme me dy gropa duke respektuar të gjitha kushtet e projektimit dhe te zbatimit që janë në fuqi në vendin tonë . Duhet theksuar që është thjeshtë një pastrim mekanik ku mbetja e llumit do të transportohet nga makinat 1 muaj. Për një trajtim më të gjërë biologjik do duhej një sipërfaqe toke më e madhe se zona që ne kemi në dispozicion , gjithashtu një kusht teknik tjetër është se distance e impiantit të trajtimit duhet të jetë jo më pak se 300 m nga objekti më I afërt I ndërtuar , kjo është e pa realizueshme në objektin tonë .një çështje për diskutim . Kushtet e zonës inuk na mundësojnë shkarkimin as të materialit të lëngshëm që del nga dekantimi ,kështu që kjo gropë do funksionojë si një pusete e madhe që duhet pastruar shumë shpesh nga ndërmarja komunale e komunës apo qytetit.

### Gropë Septike tip



DREJTOR: ING. MIMOZA HAXHIU

PERGJEGJES:ARK.ALBAN MANOKU

SPECIALIST:ING.ARIOLA BEQO

SPECIALIST:ING. FLORIANA TUSHA

SPECIALIST:ING. GARNI MYZEQARI

SPECIALIST:ING. KLAJDI MYZEQARI

SPECIALIST:ING. ARBEN MUCA